VENDIM
Nr.169, datë 31.5.2011

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT PËR TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR "TV KABLLOR KAM"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabllo", miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit Besnik Deliu, për zgjerimin e zonës së licencimit së televizionit privat kabllor "Tv kabllor KAM"

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor "Tv kabllor KAM", sipas licencës nr.038 rtv kabllor në komunën Gjoçaj.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati